

VENDIM
Nr.591, datë 14.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA SHUSHICË, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Shushicë, të qarkut të Vlorës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 12 (dymbëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Shushicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit pyje: kullota, livadhe, shkëmborë etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJËRAVE

Komuna: **Shushicë**

Fusha e përdorimit të pronës: pyll, kullote etj.

Nr.	INV sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore/kullosore	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërimit popullor)	Nr. i ngas.	Destinacioni	Sip. në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni. Enti përdorues statusi juridik	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	1	Ek.Pyj. Ane e Lumit Vjose	Al.Shush.akace argji	3/a	Sip.Bim.Pyj.	11	Prodhues	MMPAU	DSHP	
2	2	Ek.Pyj. Ane e Lumit Vjose	Shtrati i vjeter L.Shushice	3/b	Pyll	35	Prodhues	MMPAU	DSHP	
3	3	Ek.Pyj. Ane e Lumit Vjose	Plep Kanadez Beshisht	4	Sip.Bim.Pyj.	11	Prodhues	MMPAU	DSHP	
4	4	Ek.Pyj. Ane e Lumit Vjose	Fllim plep Beshisht	5/a	Sip.Bim.Pyj.	38	Prodhues	MMPAU	DSHP	
5	5	Ek.Pyj. Ane e Lumit Vjose	Plep Beshisht	5/b	Sip.Bim.Pyj.	10	Prodhues	MMPAU	DSHP	
6	6	Ek.Pyj. Ane e Lumit Vjose	Plep Beshisht	6/a	Sip.Bim.Pyj.	37	Prodhues	MMPAU	DSHP	
7	7	Ek.Pyj. Ane e Lumit Vjose	Plep Beshisht	6/b	Sip.Bim.Pyj.	31	Prodhues	MMPAU	DSHP	
8	73	Ek.P. Kume-Shashice	Dafina Risili	36	Pyll	20	Prodhues	MMPAU	DSHP	
9	122	Ek.Py. Karaburun-Beshisht	Dardha e Naxes	1	Kullote	56	Kullote	MMPAU	DSHP	
10	123	Ek.Py. Karaburun-Beshisht	Kemba e Lajthise	2	Kullote	38	Kullote	MMPAU	DSHP	
11	124	Ek.Py. Karaburun-Beshisht	Melihova	3	Kullote	73	Kullote	MMPAU	DSHP	
12	125	Ek.Py. Karaburun-Beshisht	Melihova	4	Kullote	25	Kullote	MMPAU	DSHP	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7, 73, 122-125	Pyll, kullotë etj.	Në pronësi